



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Ekstra 59**

**Gusht**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Akt normativ nr.3, datë 28.5.2008	Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura, për të marrë pjesë në operacionin “EUFOR tchad/RCA” të Bashkimit European....	3
Akt normativ nr.4, datë 9.7.2008	Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve .....	4
Akt normativ nr.5, datë 9.7.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.9025, datë 13.3.2003 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 9.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për vënien në dispozicion të hapësirës tokësore, detare e ajrore dhe dërgimin e një force ushtarake shqiptare në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit” .....	5
Vendim i KM nr.4, datë 4.1.2008	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lis të qarkut të Dibrës .....	5
Vendim i KM nr.52, datë 16.1.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.317, datë 8.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e punës së punonjësve”, të ndryshuar .....	6
Vendim i KM nr.132, datë 13.2.2008	Për paraqitjen e kërkesës për shkarkimin nga detyra të disa prej anëtarëve të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe autorizimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të përfaqësojë Këshillin e Ministrave, gjatë kësaj procedure, në Kuvend .....	6

Vendim i KM nr.149, datë 13.2.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.182, datë 21.3.2006 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Komisionit të Ndhmës Shtetërore”.....	7
Vendim i KM nr.150, datë 13.2.2008	Për një shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Ervin Kazazi, në Turqi.....	7
Vendim i KM nr.151, datë 13.2.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Gani Lolaj, në Turqi.....	8
Vendim i KM nr.153, datë 13.2.2008	Për zëvendësimin e personit të kontaktit në marrëveshjen, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë Microsoft Corporation, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit, të miratuar me vendimin nr.362, datë 20.6.2007 të Këshillit të Ministrave.....	9
Vendim i KM nr.157, datë 13.2.2008	Për caktimin e guvernatorëve dhe të zëvendësguvernatorëve të Republikës së Shqipërisë, pranë institucioneve ndërkombëtare financiare e të zhvillimit.....	9
Vendim i KM nr.159, datë 19.2.2008	Për ngritjen e përfaqësimit diplomatik në nivel ambasadori të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës dhe hapjen e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës në Prishtinë.....	11
Vendim i KM nr.160, datë 13.2.2008	Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2008, në ministritë dhe institucionet qendrore.....	11
Vendim i KM nr.162, datë 13.2.2008	Për dhënie ndihme financiare z. Kristaq Eksarko dhe familjeve të shtetasve Sami Doga dhe Kei Robert Koçiu..	13
Vendim i KM nr.166, datë 26.2.2008	Për emërimin në detyre të nënkryetarit dhe të sekretarit shkencor të kryesisë së përkohshme të Akademisë së Shkencave .....	13
Vendim i KM nr.188, datë 21.2.2008	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ujësjellës-kanalizime Shkodër (Uk Shkodër) dhe KfW, Frankfurt am Main, për projektin “Mbrojtja e mjedisit të liqenit të Shkodrës”.....	14
Vendim i KM nr.208, datë 21.2.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj. Valbona Malkaj, në Greqi....	14
Vendim i KM nr.209, datë 21.2.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Arbër Kurti, në Itali.....	15

Vendim i KM nr.211, datë 21.2.2008	Për mënyrën e trajtimit të koleksionit të armëve të zjarrit të ish-Familjes Mbretërore.....	15
Vendim i KM nr.223, datë 5.3.2008	Për propozimin për emërimin në detyrë të 5 anëtarëve të rinj të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve .....	16
Vendim i KM nr.234, datë 27.2.2008	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2008 .....	17
Vendim i KM nr.240, datë 27.2.2008	Për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Njazi Alliu	17
Vendim i KM nr.260, datë 27.2.2008	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, 2002 .....	18
Vendim i KM nr. 263, datë 10.3.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.223, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për propozimin për emërimin në detyrë të 5 anëtarëve të rinj të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve” .....	19
Vendim i KM nr.266, datë 5.3.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj. Ermira Spahiu, në Itali.....	20
Vendim i KM nr.273, datë 27.2.2008	Për një shtesë në vendimin nr.500, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave “Për njësitë e shoqërisë “ARMO”, sh.a., që nuk do të vlerësohen si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë” .....	20
Vendim i KM nr.275, datë 15.3.2008	Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në bashkinë e Vorës, në komunat Kashar e Prezë, të qarkut të Tiranës, dhe në komunat Maminas, Manzë dhe Bubq të qarkut të Durrësit	21
Vendim i KM nr.276, datë 18.3.2008	Për shpallje ditë zie kombëtare .....	22
Vendim i KM nr.277, datë 18.3.2008	Pë dhënie ndihme financiare familjeve të viktimave, të shkaktuara nga tragjedia e datës 15 mars 2008 në fshatin Gërdec, bashkia Vorë.....	22
Vendim i KM nr.300, datë 12.3.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit.....	23
Vendim i KM nr.301, datë 12.3.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z.Bardhok Preçi, në Turqi.....	23

Vendim i KM nr.302, datë 12.3.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Renato Hysenaj, në Austri .....	24
Vendim i KM nr.307, datë 12.3.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve për kurimin e fëmijës Klevia Bisha, në Turqi..	24
Vendim i KM nr.315, datë 21.3.2008	Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në bashkinë Vorë, në komunat Kashar e Prezë të qarkut të Tiranës dhe në komunat Maminas, Manzë dhe Bubq të qarkut të Durrësit, të shkaktuara nga aksidenti teknologjik .....	25
Vendim i KM nr.321, datë 19.3.2008	Për dhënie ndinme financiare familjes së shtetasit Agim Lleshi .....	29
Vendim i KM nr.334, datë 19.3.2008	Për lirimimin dhe emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Statistikave .....	29
Vendim i KM nr.335, datë 25.3.2008	Për dhënie ndihme financiare familjeve të viktimave, të shkaktuara nga tragjedia e datës 15 mars 2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë .....	30
Vendim i KM nr.340, datë 19.3.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Bajram Aliaj, në Greqi.....	30
Vendim i KM nr.342, datë 12.3.2008	Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, 2007-2013 .....	31
Vendim i KM nr.343, datë 27.3.2008	Për miratimin e burimeve dhe të procedurave të financimit të dëmeve pasurore të shkaktuara nga aksidenti teknologjik i Gërdecit .....	31
Vendim i KM nr.349, datë 27.3.2008	Për ngritjen e komisionit përzgjedhes (kp) të anëtarëve të rinj të Akademisë së Shkencave .....	32
Vendim i KM nr.354, datë 27.3.2008	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve .....	33
Vendim i KM nr.355, datë 27.3.2008	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit, për bashkëpunimin ekonomik e teknik.....	33
Vendim i KM nr.390, datë 8.4.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.277, datë 18.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie ndihme financiare familjeve të viktimave, të shkaktuara nga tragjedia e datës 15 mars 2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë”	34

Vendim i KM nr.393, datë 11.4.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.348, datë 1.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie ndihme të menjëhershme financiare punëtorëve të fabrikës së çmontimit të municioneve në Gërdec bashkia Vorë, të cilët kanë ndërprerë punën për shkak të aksidentit teknologjik të datës 15 mars 2008” .....	34
Vendim i KM nr.400, datë 8.4.2008	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pronës së paluajtshme tokë/arë nr.18, në zonën kadastrale 3 205, K-34-75 (32C), në fshatin Rranxa, komuna Bushat, dhe për një ndryshim në vendimin nr.68, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bushat, të qarkut të Shkodrës”.....	35
Vendim i KM nr.437, datë 8.4.2008	Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në deklaratën “Dekada e Romëve” .....	38

**AKT NORMATIV**  
**Nr.3, datë 28.5.2008**

**PËR DËRGIMIN NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, SI KONTRIBUT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË NJË KOMPANIE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, PËR TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN “EUFOR TCHAD/RCA”, TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Dërgimin në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, të një kompanie të Forcave të Armatosura, në kuadër të kontributit të Republikës së Shqipërisë, në operacionin “EUFOR Tchad/RCA” të Bashkimit European, në zbatim të rezolutës nr.1778, datë 25.9.2007 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

**Neni 2**

Misioni i autorizuar i kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të jetë, si më poshtë vijon:

1. Sigurimi i Shtabit të Përgjithshëm të EUFOR-it, me vendndodhje në qytetin e N’Dajmenës, Republika e Çadit.
2. Patrullimi në rajonin e qytetit të N’Dajmenës.
3. Shoqërimi dhe sigurimi i personaliteteve civile dhe ushtarake, të rëndësishme, nga aeroporti në kamp, e anasjelltas.
4. Shoqërimi dhe sigurimi i trupave, që mund të lëvizin nga kampi, që ndodhet në qytetin N’Dajmena, për në kampin, që ndodhet në qytetin Abéché, përfshirë edhe sigurimin e këtyre trupave, sipas situatës operationale.

**Neni 3**

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në operacionin “EUFOR Tchad/RCA”, për ditët e qëndrimit në këtë operacion, veç pagës mujore marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, në masën, që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 4**

Shpenzimet për pjesëmarrjen në operacionin “EUFOR Tchad/RCA” të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetur edhe në marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura për këtë qëllim.

**Neni 5**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**AKT NORMATIV**  
**Nr.4, datë 9.7.2008**

**PËR PRIVATIZIMIN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE TREGTARE DHE  
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË  
VEÇANTA, MJETEVE KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE  
NDËRMARRJEVE**

Në mbështetje të nenit 101, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Neni 1

Qëllimi i këtij akti normativ është përcaktimi i organeve dhe i kompetencave, që ato kanë, për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve.

Neni 2

Me privatizim kuptohet procesi i transferimit të së drejtës së pronësisë shtetërore te personi juridik ose fizik, privat.

Kalimi i pronës shtetërore në pronë private bëhet nëpërmjet formave të ndryshme të privatizimit, si: shitjes me ankand, tenderit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kriteret për vlerësimin e pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe procedurat e format e privatizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Kalimi i pronës shtetërore në pronë private drejtohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë, e cila përcakton kohën dhe formën e realizimit të privatizimit, për të gjitha pasuritë shtetërore, që i nënshtrohen këtij procesi.

Miratimi i privatizimit për pasuritë e luajshme kryhet nga organi, që i administron ato.

Neni 4

Organi, që kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore, që privatizohet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, është Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave.

Neni 5

Prona shtetërore jepet me qira, enfiteozë apo me kontrata të tjera, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, nga ministria përgjegjëse për ekonominë, ministrinë, institucionet e tjera, në varësi të Këshillit të Ministrave, organet përkatëse të qeverisjes vendore, që përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore, si dhe ndërmarrjet ose shoqëritë tregtare shtetërore. Kriteret, procedurat dhe mënyrat e dhënies me qira, enfiteozë apo me kontrata të tjera, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, të pronës shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6  
**Dispozita kalimtare**

Të gjitha procedurat e privatizimit, të filluara të vazhdojnë sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Neni 7

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**AKT NORMATIV**  
**Nr.5, datë 9.7.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9025, DATË 13.3.2003 “PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.1, DATË 9.3.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË HAPËSIRËS TOKËSORE, DETARE E AJRORE DHE DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË RAJONIN E GJIRIT PERSIK, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT””**

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, dhe 101, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 2 të aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 9.3.2003 të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr.9025, datë 13.3.2003, fjalët “... një kompani...” zëvendësohen me “...dy kompani...”.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.4, datë 4.1.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN LIS TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Lis të qarkut të Dibrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune



Lista me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 372 (treqind e shtatëdhjetë e dy).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.52, datë 16.1.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.317, DATË 8.7.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 7 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.317, datë 8.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1. Paga e drejtorit të përgjithshëm dhe e punonjësve të KESH, sh.a.-së, caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e organeve drejtuese të shoqërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.132, datë 13.2.2008**

**PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË DISA PREJ**  
**ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË**  
**TELEKOMUNIKACIONEVE DHE AUTORIZIMIN E MINISTRIT TË PUNËVE PUBLIKE,**  
**TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË PËRFAQËSOJË KËSHILLIN E**  
**MINISTRAVE, GJATË KËSAJ PROCEDURE, NË KUVEND**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1 2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 84 e 86 shkronja ç” të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e z. Hydajet Kopani nga detyra e anëtarit dhe kryetarit të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.

2. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e znj. Anila Kaçupi nga detyra e anëtarit të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.

3. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e z. Shyqyri Meka nga detyra e anëtarit të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.

4. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e z.Arjan Sinoimeri nga detyra e anëtarit të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.

5. Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit autorizohet të përfaqësojë Këshillin e Ministrave, gjatë zhvillimit të kësaj procedure, në Kuvend.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.149, datë 13.2.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.182, DATË 21.3.2006 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në përbërje të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, të përcaktuar në pikën 1 të vendimit nr.182, datë 21.3.2006 të Këshillit të Ministrave, në vend të z. Ledi Bianku – anëtar, caktohet znj. Ardiana Shehi – anëtar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.150, datë 13.2.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË**  
**E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E**  
**Z. ERVIN KAZAZI, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 147 519 (njëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Ervin Kazazi, në spitalin “Medica”, në Turqi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.151, datë 13.2.2008

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E Z. GANI LOLAJ, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 385 577 (treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Gani Lolaj, në spitalin Çag Hastanesi, në Turqi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.153, datë 13.2.2008**

**PËR ZËVENDËSIMIN E PERSONIT TË KONTAKTIT NË MARRËVESHJEN, NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË  
MICROSOFT CORPORATION, PËR PROJEKTIN E PARTNERITETIT STRATEGJIK NË  
FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, TË MIRATUAR ME VENDIMIN  
NR.362, DATË 20.6.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë Microsoft Corporation, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit, miratuar me vendimin nr.362, datë 20.6.2007 të Këshillit të Ministrave, në pikën 7, “Kontaktet” fjalët “... qeveria, z.Etion Kapedani, drejtor IT, (Teknologjia e Informacionit), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit...” zëvendësohen kudo me “...qeveria e Republikës së Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, drejtori...”.

2. Pika 2 e vendimit nr.362, datë 20.6.2007 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.157, datë 13.2.2008**

**PËR CAKTIMIN E GUVERNATORËVE DHE TË ZËVENDËSGUVERNATORËVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PRANË INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE  
FINANCIARE E TË ZHVILLIMIT**

Në mbështetje të ligjit nr.7515, datë 1.10.1991 “Për anëtarësinë e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet”, të ligjit nr.7525, datë 3.12.1991 “Për anëtarësinë e Republikës së Shqipërisë në Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim”, të ligjit nr.8412, datë 1.10.1998 “Për ratifikimin e kartës së Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi”, dhe të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Caktimin e Ministrit të Financave, guvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

2. Caktimin e zëvendësguvernatorit të Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

3. Caktimin e guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, guvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar.

4. Caktimin e zëvendësministrit të Financave, zëvendësguvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar.

5. Caktimin e guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, guvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Agjencisë së Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe.

6. Caktimin e zëvendësministrit të Financave, zëvendësguvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Agjencisë së Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe.

7. Caktimin e zëvendësministrit të Financave, guvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës Islamike të Zhvillimit.

8. Caktimin e zëvendësministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zëvendësguvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës Islamike të Zhvillimit.

9. Caktimin e Ministrit të Financave, guvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

10. Caktimin e zëvendësministrit të Financave, zëvendësguvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

11. Caktimin e Ministrit të Financave, guvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD).

12. Caktimin e zëvendësministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëvendësguvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD).

13. Caktimin e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Europës, përfaqësues të Republikës së Shqipërisë, pranë bordit drejtues të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB).

14. Caktimin e zëvendësministrit të Financave, përfaqësues të Republikës së Shqipërisë, pranë këshillit administrativ të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës.

15. Caktimin e zëvendësministrit të Financave, guvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim.

16. Caktimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Borxhit, pranë Ministrisë së Financave, zëvendësguvernator të Republikës së Shqipërisë, pranë Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim.

17. Të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.159, datë 19.2.2008**

**PËR NGRITJEN E PËRFAQËSIMIT DIPLOMATIK NË NIVEL AMBASADORI TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE HAPJEN E  
AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NË  
PRISHTINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e përfaqësimit diplomatik në nivel ambasadori të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës dhe hapjen e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës, në Prishtinë.
2. Shpenzimet për hapjen e përfaqësimit diplomatike të përballohen nga buxheti i viti 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.160, datë 13.2.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2008, NË MINISTRITË  
DHE INSTITUCIONET QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Numri i punonjësve buxhetorë, në vitin 2008, për ministritë dhe institucionet qendrore, është 104 716 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2008.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/Institucionet	Viti 2008
3	Kryeministria	128
	Institucione të tjera qeveritare nga të cilat:	106
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	33
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Grupi i Mbikëqyrjes	8
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:	497
	- Drejtoria e Standardeve	18
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit, nga e cila:	2109
	- Bordet e kullimit	650
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1497
10	Ministria e Financave, nga e cila:	3108
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1000
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1630
	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	22
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	43707
	- Universitetet	3833
	- Parauniversitar	38496
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1105
13	Ministria e Shëndetësisë	15408
14	Ministria e Drejtësisë, nga e cila:	4594
	- Avokati i Shtetit	40
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	400
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150
15	Ministria e Punëve të Jashtme	168
16	Ministria e Brendshme, nga e cila:	13065
	- Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11800
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	140
22	Akademia e Shkencave	45
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1415
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1401
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25
78	Ministria e Integritetit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
	<b>TOTAL</b>	<b>101612</b>
	Totali për institucionet e pavarura	3104
	<b>Totali i punonjësve buxhetorë</b>	<b>104716</b>

**VENDIM**  
**Nr.162, datë 13.2.2008**

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE Z. KRISTAQ EKSARKO DHE FAMILJEVE TË  
SHTETASVE SAMI DOGA DHE KEI ROBERT KOÇIU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, z. Kristaq Eksarko.
  2. Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, familjes së shtetasit Sami Doga.
  3. Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, familjes së Kei Robert Koçiu.
  4. Fondi për përballimin e pagesave të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, grupi 25, titulli 10 430, kap 1, artikulli 606, “Transferta të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
  5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
  6. Vendimet nr.893, datë 29.12.2007 “Për dhënien e një ndihme financiare z. Kristaq Eksarko”, nr.894, datë 29.12.2007 “Për dhënien e një ndihme financiare familjes së shtetasit Sami Doga” dhe nr.895, datë 29.12.2007 “Për dhënien e një ndihme financiare familjes së Kei Robert Koçiu” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.166, datë 26.2.2008**

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË NËNKRYETARIT DHE TË SEKRETARIT SHKENCOR  
TË KRYESISË SË PËRKOHSHME TË AKADEMISË SË SHKENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 11 të ligjit nr.9853, datë 26.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Z. Gudar Beqiraj emërohet nënkryetar i kryesisë së përkohshme të Akademisë së Shkencave.
  2. Z. Jani Thomai emërohet sekretar shkencor i kryesisë së përkohshme të Akademisë së Shkencave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.188, datë 21.2.2008**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR (UK SHKODËR) DHE KFW, FRANKFURT AM MAIN, PËR PROJEKTIN “MBROJTJA E MJEDISIT TË LIQENIT TË SHKODRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ujësjellës-kanalizime Shkodër (Uk Shkodër), dhe KfW, Frankfurt am Main, për projektin “Mbrojtja e mjedisit të liqenit të Shkodrës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.208, datë 21.2.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E ZNJ. VALBONA MALKAJ, NË GREQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, në zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj.Valbona Malkaj, në Greqi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Paga të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.209, datë 21.2.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E  
Z. ARBËR KURTI, NË ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, në zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 7 685 000 (shtatë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, për përbalimin e shpenzimeve për kurimin e z. Arbër Kurti, në Poliklinikën S.Orsola-Malpighi, në Bolonja, Itali.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor.
  4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.211, datë 21.2.2008**

**PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT TË KOLEKSIONIT TË ARMËVE TË ZJARRIT TË ISH-  
FAMILJES MBRETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5 të ligjit nr.9063, datë 8.5.2003 “Për statusin e trashëgimtarëve të ish-familjes Mbretërore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Trashëgimtarët e familjes së Mbretit Zog kanë të drejtë të mbajnë, në mjediset e vendbanimit të përhershëm, koleksionin privat të armëve (të lehta) të zjarrit, por pa municion, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullave, të përcaktuara në këtë vendim.
2. Koleksioni i armëve të zjarrit, përpara se t’u dorëzohet të regjistrohet dhe më pas të mbahet, në vazhdimësi, i inventarizuar, në llogari të veçantë, nga strukturat e Policisë së Shtetit.  
Elemente të këtij koleksioni, të cilësuar nga komisioni i përhershëm i objekteve të trashëgimisë kulturore si objekte të kësaj trashëgimie, të regjistrohen dhe pajisen me pasaportë, nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore.
3. Ruajtja e koleksionit të armëve të bëhet në një magazinë të posaçme, e cila të sigurohet me roje të armatosura, me shërbim 24 orësh. Ky shërbim të sigurohet edhe në vendin e ekspozimit të armëve, për sa kohë ato mbahen të ekspozuara.

4. Trashëgimtarët e ish-familjes Mbretërore, për ruajtjen dhe magazinimin e koleksionit, janë të detyruar të lidhin kontratë me një shoqëri të ruajtjes dhe sigurisë fizike, të licencuar.

5. Lëvizja e koleksionit të armëve, për arsye të ndryshme, jashtë mjediseve të ruajtjes së përhershme, të bëhet me leje të Policisë së Shtetit.

Ndërsa për lëvizjen e objekteve, të cilësuar si objekte të trashëgimisë kulturore, jashtë mjediseve të ruajtjes së përhershme, para lejes nga Policia e Shtetit duhet të merret leja nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

6. Për parandalimin e cenimit të rëndë të rendit dhe të sigurisë publike apo në raste kur vërehet mosplotësimi i kushteve dhe i rregullave për ruajtjen dhe administrimin e sigurt të koleksionit, Policia e Shtetit e merr koleksionin në ruajtje të përkohshme, deri në rregullimin e kushteve/të situatës.

7. Struktura përkatëse e Policisë së Shtetit ka të drejtë të kontrollojë, në çdo kohë, respektimin dhe zbatimin e rregullave, të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktet e tjera nënligjore, në fuqi.

8. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë udhëzime, ku të përcaktohen rregullat, për t'i bërë të paefektshme për qitje armët e këtij koleksioni, dhe rregullat teknike, për dorëzimin e ruajtjen e tyre, në zbatim të këtij vendimi.

9. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.223, datë 5.3.2008**

**PËR PROPOZIMIN PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË 5 ANËTARËVE TË RINJ TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Propozim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për emërimin në detyrë të anëtarëve të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, pas mbetjes së vendeve vakant, si më poshtë vijon:

- Zj.Edlira Kasaj;
- Z. Benon Paloka;
- Z. Ilir Shehu;
- Z. Afrim Tonuzi;
- Z. Jetmir Karini.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.234, datë 27.2.2008**

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË  
PROJEKTAKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E  
MINISTRAVE GJATË VITIT 2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2008, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.240, datë 27.2.2008**

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT NJAZI ALLIU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, familjes së shtetasit Njazi Alliu.
2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2008, grupi 25, titulli 10 430, kap 1, artikulli 606, “Transferta të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.260, datë 27.2.2008**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 2002**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2002.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM**  
**FINACIAR (2002)**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

*në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë ,*

*duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,*

*të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke u referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 shtator 2006 në Tiranë, u morën vesh si vijon:*

**Neni 1**

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vleftë prej gjithsej 5 000 000 euro (me fjalë: pesë milionë euro) për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit (komponentë “Shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec II)”.

2. Nëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë bien dakord, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo mosmarrëveshje.

## Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të lidhet midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragr. 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2010.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundojë sipas paragrafit 1.

## Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

## Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, si edhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen këtyre ndërmarrjeve transportuese.

## Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datën 16.1.2008 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

## VENDIM

Nr. 263, datë 10.3.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.223, DATË 5.3.2008 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PROPOZIMIN PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË 5 ANËTARËVE TË  
RINJ TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË  
TELEKOMUNIKACIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, dhe të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.223, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave, në listën e kandidatëve z. Benon Paloka zëvendësohet me z. Ilir Zela.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.266, datë 5.3.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E ZNJ. ERMIRA SPAHIU, NË ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, në zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 3 900 000 (tre milionë e nëntëqind mijë) lekë, për përballimin e pjeshëm të shpenzimeve për kurimin e znj.Ermira Spahiu, në Institutin Ortopedik Rizzoli, në Bolonja, Itali.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.273, datë 27.2.2008**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.500, DATË 21.9.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJËSITË E SHOQËRISË “ARMO”, SHA, QË NUK DO TË VLERËSOHEN SI PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të “ARMO”, sh.a.-së, Fier”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.500, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave, në listën e njërive të shoqërisë, ARMO, sh.a., që nuk do të vlerësohen si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë të shtohen edhe këto njësi:

- Dega e shpërndarjes së karburantit, Lushnjë;
- Dega e shpërndarjes së karburantit, Tiranë;
- Dega e shpërndarjes së karburantit, Elbasan;
- Dega e shpërndarjes së karburantit, Laç;
- Dega e shpërndarjes së karburantit, Sarandë;
- Dega e shpërndarjes së karburantit, Pogradec;
- Dega e shpërndarjes së karburantit, Gjirokastër.”.

2. Njësitë e shtuara në pikën 1 të këtij vendimi të shërbejnë për krijimin e një shoqërie të re, me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.275, datë 15.3.2008**

**PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE NË BASHKINË E VORËS,  
NË KOMUNAT KASHAR E PREZË, TË QARKUT TË TIRANËS, DHE NË KOMUNAT  
MAMINAS, MANZË DHE BUBQ TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, shkronja “c”, e 6, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile, si pasojë e aksidentit teknologjik, të ndodhur sot më 15.3.2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, që ka dëmtuar, përkatësisht, bashkinë e Vorës dhe komunat Prezë e Kashar të qarkut të Tiranës, dhe komunat Maminas, Manzë e Bubq të qarkut të Durrësit.

2. Krijimin e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, të kryesuar nga zëvendëskryeministri, i cili në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Ministrin e Punëve të Jashtme;
- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile të marrë masat urgjente, për t’i ardhur në ndihmë popullatës së zonave të prekura dhe për eliminimin, sa më shpejt, të dëmeve materiale.

4. Komiteti të bashkërendojë punën me të gjitha institucionet dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, që kanë ofruar ndihmën e tyre materiale dhe shëndetësore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha



**VENDIM**  
**Nr.276, datë 18.3.2008**

**PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen ditë zie kombëtare ditën e martë, datë 18 mars 2008, në nderim të viktimave, të shkaktuara si pasojë e aksidentit teknologjik, të ndodhur në fshatin Gërdec, bashkia Vorë.

2. Në të gjitha institucionet, shtetërore dhe publike, flamuri kombëtar të ulet në gjysmë shtizë. Në orën 12.00, në nderim të viktimave, të ndërpritet çdo veprimtari dhe të mbahet një minutë heshtje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.277, datë 18.3.2008**

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE, TË SHKAKTUARA  
NGA TRAGJEDIA E DATËS 15 MARS 2008 NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e një ndihme financiare familjeve të viktimave, që kanë humbur jetën në tragjedinë e datës 15.3.2008, si pasojë e aksidentit teknologjik, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë për çdo pjesëtar, që ka humbur jetën.

2. Fondi i përgjithshëm, në shumën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, t’i shtohet Ministrisë së Brendshme në buxhetin e miratuar për vitin 2008, për përballimin e shpenzimeve, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.300, datë 12.3.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË SHIJAK TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.469, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Shijakut”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.301, datë 12.3.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E Z.BARDHOK PREÇI, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 5 771 000 (pesë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Bardhok Preçi, në Turqi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. PAGESA të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.302, datë 12.3.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E  
Z. RENATO HYSENAJ, NË AUSTRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 484 000 (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z. Renato Hysenaj, në qendrën shëndetësore “Kursana”, në Austri.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale.
  4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.307, datë 12.3.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E  
FËMIJËS KLEVIA BISHA, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 587 000 (pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e fëmijës Klevia Bisha, në spitalin “Erdem”, në Turqi.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale.
  4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.315, datë 21.3.2008**

**PËR EVIDENTIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE NË BASHKINË VORË, NE  
KOMUNAT KASHAR E PREZE TË QARKUT TË TIRANËS DHE NË KOMUNAT  
MAMINAS, MANZË DHE BUBQ, TË QARKUT TË DURRËSIT, TË SHKAKTUARA NGA  
AKSIDENTI TEKNOLOGJIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e aksidentit teknologjik të datës 15.3.2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, të qarkut të Tiranës, si dhe në komunat Maminas, Manzë, Bubq të qarkut të Durrësit.

2. Grupet e punës kanë në përbërje të tyre specialistët, si më poshtë vijon:

Për bashkinë Vorë:

- Përfaqësues të bashkisë Vorë 3 anëtarë;
- Përfaqësues të caktuar nga këshilli i qarkut 2 anëtarë;
- Përfaqësues të ALUIZNI-t 2 anëtarë.

Për njësitë e tjera të qeverisjes vendore:

- përfaqësues nga secila komunë 3 anëtarë;
- përfaqësues të këshillit të qarkut 2 anëtarë.

Caktimi i anëtarëve në grupet e punës bëhet nga kryetarët e bashkive e të komunave përkatëse, sipas përcaktimeve të bëra më sipër.

3. Kryerjen e evidentimit të dëmeve të objekteve të banimit, objekteve të biznesit, objekteve sociale e publike apo të orendive shtëpiake, sipas formularëve tip 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Vlerësohen si ndërtime të shkatërruara tërësisht, objektet, të cilave u është dëmtuar krejtësisht konstruksioni mbajtës e që duhet të ndërtohen nga e para.

5. Formularët e plotësuar të dorëzohen nga grupet e punës të evidentimit të dëmeve, pranë këshillit përkatës të qarkut, i cili së bashku me listën emërore të pronarëve të banesave apo të objekteve të tjera t’ia përcjellë Entit Kombëtar të Banesave, si organ i specializuar, për kryerjen e vlerësimit përfundimtar.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar, së bashku me Entin Kombëtar të Banesave, të marrin pjesë edhe specialistë nga ALUIZNI, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

6 Vlerësimi e dëmeve të kryhet si më poshtë vijon:

a) për objektet e shkatërruara tërësisht, sipas kostos së ndërtimit për m<sup>2</sup> miratuar me udhëzimin nr.2, datë 4.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit “k” , për vitin 2007” (për qytetin e Tiranës);

b) për objektet e ndërtimit me karakter bujqësor, të tilla si stalla, hangarë etj. kostoja e ndërtimit të llogaritet sa 0.2 e kostos për m<sup>2</sup>, të llogaritur në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) për kategoritë e tjera të dëmtimeve në objekte, llogaritja të bëhet me çmimet, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar për qytetin e Tiranës, për vitin 2007 të Entit Kombëtar të Banesave.

7. Vlerësimi i makinerive dhe i pajisjeve të dëmtuara të kryhet në përputhje me dokumentacionin e depozituar në organet tatimore.

8. Vlerësimi për orenditë dhe pajisjet e dëmtuara të kryhet si më poshtë vijon:

a) Familjet, banesat e të cilave, janë shkatërruar tërësisht, të dëmshpërblehen me 200 000 (dyqind mijë) lekë për frymë, por jo me pak se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për familje;

b) Për familjet e tjera, vlerësimi i pajisjeve dhe orendive shtëpiake të dëmtuara, të evidentuara si të tilla, të kryhet sipas çmimit të tregut, marrë nga organet tatimore;

c) Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në gjënë e gjallë të kryhet sipas çmimeve të tregut, marrë në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

9. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, prefektët e qarqeve Tiranë e Durrës, kryetari i bashkisë Vorë, si dhe kryetarët e komunave Prezë, Kashar, Maminas, Bubq dhe Manzë, për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij nga data 15 mars 2008.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## FORMULAR VLERËSIMI NR.1 PËR PAJISJE DHE ORENDI SHTËPIAKE

NR \_\_\_\_\_

Data .....03.2008.

NJESIA VENDORE \_\_\_\_\_

Emri Mbiemri i Qytetarit \_\_\_\_\_

VENDBANIMI:LAGJA \_\_\_\_\_

FSHATI \_\_\_\_\_

Nr.	Emertimi	Banesa te Shkaterruara Totalisht					Banesa me Demtime te Renda					Banesa me Demtime Mesatare					Banesa me Demtime te lehta					
		Lloji	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Lloji	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Lloji	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Lloji	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	
1	Çatia																					
2	Muratura																					
3	Themeli																					
4	Xoklatura																					
5	Dyshemeja																					
6	Tavani																					
7	Dritare																					
8	Dyert																					
9	Instalimet elektrike																					
10	Instalimet hidraulike																					
11	Instalimet e ngrohjes																					
12	Suvatimi																					
13	Kuneta																					
14	Kanalizime																					
15	Hidro/Termoizolimi																					
16	Te tjera																					
	<b>Vlefte ne Total</b>																					

### KOMISIONI

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

FORMULAR VLERËSIMI NR.2 PËR PAJISJE DHE ORENDI SHTËPIAKE

NR. \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_ .03.2008.

NJESIA VENDORE \_\_\_\_\_

BANESA E QYTETERIT \_\_\_\_\_

VENDBANIMI: LAGJJA \_\_\_\_\_ FSHATI \_\_\_\_\_

Nr.	Orendi shtepiake	Njesia	sasia	Çmimi	Vlefte
1	Kundrabufe				
2	Sobe elektrike				
3	Tv				
4	Lavatrice				
5	Mallra ushqimore				
6	Mallra ne veshmathje				
7	paisje elektrike				
9	Orendi te tjera				
10	Te tjera				
11	Total				

KOMISIONI

Antar \_\_\_\_\_

Antar \_\_\_\_\_

Antar \_\_\_\_\_

Antar \_\_\_\_\_

Antar \_\_\_\_\_

**VENDIM**  
**Nr.321, datë 19.3.2008**

**PËR DHËNIE NDINME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT AGIM LLESHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien një ndihmë të menjëhershme financiare, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, familjes së shtetasit Agim Lleshi.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2008, grupi 25, titulli 10430, kap. I, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministrja e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.334, datë 19.3.2008**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DY ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1 Z.Bardhyl Çeku dhe z Kreshnik Spahiu, anëtarë të Këshillit të Statistikave, lirohen nga ky funksion.

2. Znj. Suzana Panariti dhe z. Dritan Shutina emërohen anëtarë të Këshillit të Statistikave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.335, datë 25.3.2008**

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE, TË SHKAKTUARA NGA TRAGJEDIA E DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e një ndihme financiare familjeve të viktimave, që kanë humbur jetën në tragjedinë e datës 15.3.2008, si pasojë e aksidentit teknologjik në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë për çdo pjesëtar, që ka humbur jetën.

2. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi

3 Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.340, datë 19.3.2008**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E Z. BAJRAM ALIAJ, NË GREQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 ( katër milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve, për kurimin e z.Bajram Aliaj në klinikën e përgjithshme të Iasos, në Greqi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.342, datë 12.3.2008**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM,  
2007-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, 2007-2013, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.343, datë 27.3.2008**

**PËR MIRATIMIN E BURIMEVE DHE TË PROCEDURAVE TË FINANCIMIT TË  
DËMEVE PASURORE TË SHKAKTUARA NGA AKSIDENTI TEKNOLOGJIK I  
GËRDECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Financimi i dëmeve pasurore, të shkaktuara nga aksidenti teknologjik i Gërdecit, bëhet në përputhje me listën dhe vlerën përkatëse, të miratuara në vendimin nr.336, datë 24.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së dëmeve, të shkaktuara në objektet, pronë private, si rrjedhojë e aksidentit të ndodhur në Gërdec”.

2. Burimet e financimit të dëmeve pasurore, sipas vendimit të sipërpërmendur, në vlerën 1 572 milionë lekë, janë, si më poshtë vijon:

a) Dhurimet e derdhura në llogaritë bankare, të hapura për këtë qëllim, në masën 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

b) Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, në masën 800 000 000 (tetëqind milionë) lekë;

c) Fondi i kontingjencës, në masën 622 000 000 (gjashtëqind e njëzet e dy milionë) lekë.

Dhurimet, nëse rezultojnë mbi vlerën e mësipërme, të rimbursojnë fondin e kontingjencës.

3. Financimi i dëmeve të përfituesve bëhet vetëm në llogaritë bankare, të hapura në emër të tyre, duke zbatuar procedurat e mëposhtme:

a) Njësitë e qeverisjes vendore, në mbështetje të listave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, hartojnë listëpagesat përkatëse.

b) Listëpagesat përmbajnë: emrin, atësinë dhe mbiemrin e përfituesit, vlerën e dëmshpërblimit dhe referencat e llogarisë bankare.

c) Njësitë e qeverisjes vendore depozitojnë në Ministrinë e Financave listëpagesat, zyrtarisht dhe në formë elektronike.

ç) Ministria e Financave, në mbështetje të listëpagesave, të përmendura në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij vendimi, urdhëron kryerjen e pagesës, nga llogaria e hapur për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë drejtpërdrejt në llogarinë bankare të përfituesve.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.349, datë 27.3.2008**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHES (KP) TË ANËTARËVE TË RINJ TË**  
**AKADEMISË SË SHKENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.9853, datë 26.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9655, datë 12.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e komisionit për zgjedhës të anëtarëve të rinj të Akademisë së Shkencave, me këtë përbërje:

- |                                   |          |
|-----------------------------------|----------|
| a) Prof. dr. Gudar Beqiraj        | kryetar; |
| b) Prof. dr. Dhimitër Haxhimihali | anëtar;  |
| c) Prof. dr. Farudin Hoxha        | anëtar;  |
| ç) Prof. dr. Jani Thomai          | anëtar;  |
| d) Prof. dr. Francesko Altimari   | anëtar;  |
| dh) Prof dr Azedine Beschaouch    | anëtar;  |
| e) Prof. dr. Franz Hofmann        | anëtar;  |
| e) Prof. dr. Walter Hoflechner    | anëtar;  |
| f) Prof. dr. Sandro De Maria      | anëtar.  |

2. Akademisë së Shkencave, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t'i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të udhëtimit

e të qëndrimit të shkencëtarëve të huaj, anëtarë të komisionit përzgjedhës.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.354, datë 27.3.2008**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT,  
PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.355, datë 27.3.2008**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT,  
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK E TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit, për bashkëpunimin ekonomik e teknik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.390, datë 8.4.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 277, DATË 18.3.2008 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE,  
TË SHKAKTUARA NGA TRAGJEDIA E DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN  
GËRDEC, BASHKIA VORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 2 të vendimit nr.277, datë 18.3.2008 të Këshillit të Ministrave, shifra “20 000 000 (njëzet milionë) lekë” zëvendësohet me “28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë”.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.393, datë 11.4.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.348, DATË 1.4.2008 TË KËSHILLIT  
MIMINISTRAVE “PËR DHËNIE NDIHME TË MENJËHERSHME FINANCIARE  
PUNËTORËVE TË FABRIKËS SË ÇMONTIMIT TË MUNICIONEVE NË GËRDEC  
BASHKIA VORË, TË CILËT KANË NDËRPRERË PUNËN PËR SHKAK TË  
AKSIDENTIT TEKNOLOGJIK, TË DATËS 15 MARS 2008”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI**

Pika 1 e vendimit nr.348, datë 1.4.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon.

“1. Dhënien e një ndihme të menjëherëshme financiare, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo punëtor, i cili më 15 mars 2008, datë kur ndodhi aksidenti teknologjik, ka qenë i pranishëm në fabrikën e çmontimit të municioneve, në Gërdec.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.400, datë 8.4.2008**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË  
DREJTËSISË, TË PRONËS SË PALUAJTSHME TOKË/ARË NR.18, NË ZONËN  
KADASTRALE 3 205, K-34-75 (32C), NË FSHATIN RRANXA, KOMUNA BUSHAT,  
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.68, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE  
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI  
OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS BUSHAT, TË QARKUT TË SHKODRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pronës së paluajtshme, tokë/arë, nr.18, në zonën kadastrale 3 205, K-34-75 (32C), në fshatin Rranxa, komuna Bushat, me sipërfaqe 8.24 ha.

2. Komunës Bushat i hiqet e drejta e përdorimit për pasurinë tokë arë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.


3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr.68, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, komunës Bushat, të qarkut të Shkodrës”, hiqet ajo pjesë e pasurisë, që me këtë vendim, i kalon në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**







**VENDIM**  
**Nr.437, datë 8.4.2008**

**PËR ANËTARËSIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DEKLARATËN “DEKADA E ROMËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në deklaratën “Dekada e romëve”.
2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda një jave nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përgatisë planin kombëtar të veprimit, për zbatimin e deklaratës “Dekada e romëve”.
3. Ngarkohet sektori i monitorimit të zbatimit të strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për monitorimin e planit kombëtar të veprimit, për zbatimin e deklaratës “Dekada e romëve”.
4. Kontributi fillestar prej 20 000 eurosh, që është vetëm për anëtarësimin në këtë nismë, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme të verë në dijeni, në rrugë diplomatike, presidencën hungareze, për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në deklaratën “Dekada e romëve”.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 2.8.2010

Doli nga shtypi më 4.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 42 lekë